

**Takimi i 5-të i Nën-Komiteti për Inovacionin, Shoqërinë e Informacionit dhe Politikën Sociale**

**Takim Virtual, 10 shkurt 2021**

**KONKLuzionet**

*Konkluzionet gjithëpërfshirëse*

- Komisioni i rekomandoi Kosovës që të shfrytëzojë sa më mirë IPA-në duke transferuar praktikën e mirë në pjesë të tjera të administratës publike. Komisioni gjithashtu rekomandoi adresimin e rekomandimeve përkatëse që burojnë nga raporti i Gjykatës Evropiane të Auditorëve.
- Komisioni rekomandoi që hartimi i strategjive dhe legjislacionit të shoqërohet me konsultim të duhur të palëve të interesit, me alokimin e burimeve të përshtatshme për objektivat e strategjisë ose ligjit përkatës, për të favorizuar cilësinë mbi shpejtësinë, për të përmirësuar mbledhjen dhe cilësinë e të dhënave dhe statistikave dhe për të siguruar mekanizëm monitorimi dhe vlerësimi për zbatimin e strategjisë.
- Komisioni i rekomandoi Kosovës që të përmirësojë koordinimin ndërministror dhe ndërinstytucional gjatë përgatitjes, implementimit dhe monitorimit të politikave.
- Të adresohen aftësitë e TIK-ut në mënyrë të integruar në Strategjinë e ardhshme Digjitale dhe Strategjinë e Arsimit, duke marrë gjithashtu parasysh nevojat e tregut të punës.

Shoqëria e Informacionit, Komunikimet Elektronike dhe Politikën Audio-Vizuale

- Të miratohet **Strategjia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike** dhe Plani përkatës i Veprimit, duke siguruar që të ndahen burime të mjaftueshme për zbatimin e tij [TM3 2021].
- Të sigurohet pajtueshmëri me **Direktivën NIS** [TM2 2022]
- Të miratohet ligji kombëtar në përputhje me **eIDAS** [TM3 2021].
- Të avancohet pajtueshmëria me **Kodin e Komunikimeve Elektronike të BE-së** [TM4 2022].
- Të miratohet draft **Strategjia e E-Qeverisjes** dhe Plani përkatës i Veprimit [TM3 2021].
- Komisioni fton Kosovën të shfrytëzojë fondet e BE-së (30 milionë €) në dispozicion për asistencë teknike për projektet e rrjetit brezgjërë në kuadër të **Fondit të Investimeve të Ballkanit Perëndimor** (WBIF).
- Të implementohet **bartshmëria e numrave** për të siguruar përdorimin efektiv të burimeve të numeracionit dhe nxitjen e konkurrencës dhe kushteve të barabarta për të gjithë [TM2 2021].

- Të sigurohet pavarësia financiare dhe organizative e **Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare**, veçanërisht forcimi i burimeve të tij njerëzore dhe financiare në mënyrë që të mundësohet funksionimi i tij i duhur [TM3 2021].
- Të përafrohet legjislacioni me **Direktivën e Shërbimeve Mediale Audio-Vizuale**, përfshirë rishikimin më të fundit të vitit 2018 [TM4 2021].
- Të lirohet dividendi i parë digjital/**të çlirohen frekuencat** [TM3 2021].
- Të sigurohet **pavarësia dhe qëndrueshmëria financiare e transmetuesit publik** [TM3 2021] në përputhje me dispozitat e Direktivës për Shërbimet Mediale Audio-Vizuale dhe standardet dhe rekomandimet e tjera përkatëse Evropiane.
- Të merren hapa për të përmirësuar transparencën dhe forcuar pavarësinë e **Komisionit të Pavarur të Mediave** në përputhje me dispozitat e Direktivës për Shërbimet Mediale Audio-Vizuale dhe standardet dhe rekomandimet e tjera përkatëse Evropiane [TM2 2021].
- Të sigurohet sinergjia bazë midis **politikave të gjelbra dhe atyre digjitale**.
- Të merren hapa për të siguruar zbatimin e suksesshëm të **Memorandumeve të Mirëkuptimit mbi 5G-në dhe interoperabilitetin**, në përputhje me praktikatat e BE-së, të nënshkruara në Samitin Digjital të Tiranës.

#### Politikat Sociale dhe Punësimi

- Të miratohet **Ligji i Punës** dhe aktet nënligjore përkatëse, në përputhje me *acquis* përkatëse të BE-së, përfshirë këtu pushimin e lehonisë dhe pushimin prindëror dhe mos diskriminimin në punësim dhe politikatat sociale [TM3 2021].
- Të merren hapat e parë për të krijuar **sistemin e sigurimeve shoqërore** në mënyrë që të sigurohen të njëjtat garanci sipas konventës së ILO-së të standardeve minimale të sigurimeve shoqërore. Të përfundohet reforma e skemës së veteranëve të luftës [TM4 2021].
- Të sigurohet udhërrëfyes për zbatimin e reformave në **Arsimin dhe Aftësimin Profesional (AAP)**, përfshirë qeverisjen, financimin dhe kurrikulën [TM1 2021] dhe të shpërndahet informacioni mbi hapat e ardhshëm për AAP, duke përfshirë gjendjen momentale në lidhje me shkollat e AAP, qendrat e AAP dhe kurrikulën [TM1 2021].
- Të vazhdojnë përpjekjet për implementimin e **legjislacionit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë**.
- Të sigurohet që **Inspektorati i Punës** ka burimet e duhura për të përmbushur mandatin e tij [TM4 2021].
- Të miratohet **Projektligji për Këshillin Ekonomik dhe Social** [TM3 2021].
- Të sigurohet që **marrëveshjet kolektive** diskutohen siç duhet me palët e prekura të interesit dhe të sigurohet buxheti i nevojshëm për zbatimin e tyre. Të ndahen draftet e marrëveshjeve kolektive me Komisionin Evropian.
- Të promovohet respektimi i **lirisë së asociimit**, për të gjithë punëtorët, në dialog me ILO-në, BE-në dhe palët e tjera përkatëse të interesit.
- Të sigurohet ofrimi i **shërbimeve sociale nga komunat**, përfshirë ose me caktimin e fondeve specifike nga granti i përgjithshëm ose përmes krijimit të një granti specifik për shërbimet sociale përmes ndryshimeve në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal [TM2 2021].

- Të vazhdohet implementimi i konkluzioneve të **Seminarit të vitit 2018 për Romët** dhe të sigurohen përditësime të rregullta mbi progresin e Komisionit.

### Arsimi dhe Rinia

- Të përmirësohet cilësia dhe mbulimi i **trajnitimit online**, duke siguruar vazhdimësinë e mësimin në distancë dhe trajnimin online të mësimdhënësve [TM2 2021].
- Të vazhdohet publikimi i të **dhënave të sakta** në fushat e arsimit dhe rinisë, të dhëna këto të cilat duhet të jenë të matshme, të gjurmueshme dhe të krahasueshme me kalimin e kohës. Të sigurohet që Sistemi i Menaxhimit të Informatave të Arsimit të zhvillohet tutje për të përmbushur nevojat aktuale dhe të ardhshme në këtë fushë.
- Të njoftohet OECD-ja lidhur me vendimin përfundimtar në lidhje me pjesëmarrjen e Kosovës në **PISA 2022** [TM1 2021].
- Të përmirësohet zbatimi i **Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2021** [2021]. Të fillohen përgatitjet për strategjinë e re afatmesme, në koordinim të ngushtë me të gjitha palët relevante të interesit [TM3 2021].
- Të miratohet **Ligji për Zhvillimin në Fëmijërinë e Hershme, Ligji për Arsimin Parashkollor**, të përgatitet dhe miratohet **Ligji për Tekstet dhe Materialet Mësimore**, dhe të avancohen përgatitjet për zbatim, dhe të avancohen përgatitjet e **Ligjit** të rishikuar **për Arsimin e Lartë** [TM3 2021]
- Të rishikohen **tekstet shkollore** ekzistuese [TM2 2021] dhe të nxirren **tekste shkollore të reja** [TM4 2021] për arsimin parauniversitar, në mënyrë gjithëpërfshirëse duke përfshirë konsultimin e të gjitha palëve të interesit, për të mbështetur një reformë të duhur.
- Të përgatitet dhe miratohet **Ligji për Agjencinë Kosovare të Akreditimit** [TM4 2021].
- Të vazhdohen përpjekjet për rritjen e **shkallës së regjistrimit në fëmijërinë e hershme** të fëmijëve 0-5 vjeç, duke vazhduar shtimin e numrit të **objekteve të kujdesit për fëmijët**.
- Të përmirësohet **cilësia e arsimit** në të gjitha nivelet duke aplikuar në mënyrë sistematike mekanizmat ekzistues të sigurimit të cilësisë, siç janë koordinatorët e cilësisë, inspektimet e shkollave në arsimin fillor, dhe të sigurohet monitorimit i rreptë i kushteve të Agjencisë Kosovare të Akreditimit për akreditimin e programeve të arsimit të lartë.
- Të ndërmerren hapa konkretë për të siguruar burime për **zhvillimin profesional** të mësuesve dhe të ndërlidhen pagat e mësuesve me trajnimet dhe performancën e tyre [TM3 2021].
- Autoritetet t'i mbështesin përpjekjet e **Agjencisë Kosovare të Akreditimit** në përmbushjen e rekomandimeve të Regjistrimit Evropian për Sigurimin e Cilësisë. Të emërohen anëtarë të rinj të në bordin e AKA-së në përputhje me parimet ekzistuese të transparencës dhe meritës (TM2 2012). Të shqyrtohet opsioni i aplikimit për statusin e anëtarit vëzhgues në Regjistrin Evropian për Sigurimin e Cilësisë dhe Shoqatën Evropiane për Sigurimin e Cilësisë.
- Komisioni rekomandoi **adresimin e rrezikut të korrupsionit dhe ndikimit politik**, në konsultim të ngushtë me studentët, dhe raporti mbi veprimet e ndërmarra duke përfshirë ato sa i përket përzgjedhjes meritore të stafit mësimdhënës dhe menaxhues [TM2 2021].

- Të vazhdohen përpjekjet për të rritur **shkallën e regjistrimit** të nxënësve/studentëve me nevoja të veçanta.
- Të mbështeten Institucionet e Arsimit të Lartë me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes në **programin e ri Erasmus+**.

#### Trashëgimia Kulturore

- Të ruhet frekuenca e takimeve të **Këshillit për Zbatim dhe Monitorim (KZM)** dhe të identifikohen zgjidhje të përbashkëta që duhen arritur mes Kosovës dhe Kishës Ortodokse Serbe në bazë të vullnetit të mirë dhe bashkëpunimit.
- Të demonstronhet vazhdimisht një **regjistër** i shembujve konkret ku autorët e ndërtimeve ilegale ose prishjes së vendeve të trashëgimisë kulturore janë përballur me masa ndëshkuese dhe pasoja ligjore për veprimet e tyre, duke përfshirë informacionin se si vendimet ligjore janë zbatuar nga autoritetet (zbatimi i akteve juridike).
- Të konsultohet **projektligji për Trashëgiminë Kulturore** me të gjithë akterët e interesuar (Kisha Ortodokse Serbe, OSBE-ja dhe Zyra e BE-së/ EUR) dhe të fillohen konsultimet publike mbi draftin [TM2 2021] me qëllim të miratimit të tij [TM4 2021]. Të sigurohet zbatim efektiv me shtjellimin e rregulloreve adekuate të zbatimit.

#### Shkenca dhe Inovacioni

- Të vazhdohet ofrimi i të **dhënave statistikore** (sipas Manualit Frascati të OECD-së) për sasinë dhe përqindjen e BPV-së të shpenzuar në **Kërkime dhe Inovacion**, dhe për performancën në lidhje me **Prioritetet e Zonës Evropiane të Kërkimit**.
- Të bëhen përgatitje për pjesëmarrjen e Kosovës në ushtrimin e Fletënotimit Evropian për Inovacion (ang. "European Innovation Scoreboard") [TM4 2022].
- Të vazhdohet në mënyrë aktive zhvillimi i **Strategjisë për Specializim të Mençur**. Të përfundohet deri në [TM4 2021].
- [Të përfundohet zhvillimi/të miratohen] **ligjet** dhe aktet nënligjore që kanë të bëjnë me Kërkimin dhe Inovacionin dhe të avancohet implementimi i tyre [TM3 2021].
- Të përfundohet **hartëzimi i infrastrukturës së kërkimit dhe zhvillimit** (së bashku me ekonomitë e tjera dhe të koordinuara nga RCC) [TM2 2021].

